



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

**AD/GJTHPE/.nr.13/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj ....., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Pejë – Dega në Klinë, duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga ....., avokat në Klinë, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 17.09.2021, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore të parashtruar nga ....., avokat në Klinë, ndaj gjyqtarit ....., **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 19.08.2021, ....., avokat në Klinë, ka dorëzuar një parashtrësë me titull “Njoftim” për vërejtje ndaj gjyqtarit .....përmes të cilës shkresë e ka njoftuar Kryetarin e Gjykatës se si avokat i ri ndjehet i shqetësuar dhe ka vërejtje serioze ndaj gjyqtarit .....meqë i njëjti si avokat që nga viti 2017 e deri në vitin 2021, në vazhdimësi ka dorëzuar lëndë pranë Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Klinë dhe shumica e lëndëve civile kanë rënë te gjyqtari në fjalë, i cili, sipas pretendimeve të avokatit nuk ia ka caktuar në shqyrtim, për tri vite e më shumë radhazi duke shtuar se ka bazë se i njëjti gjyqtar cakton në shqyrtim lëndë më të reja sa i përket regjistrimit në vitet kalendarike. I njëjti ka shtuar se gjyqtari në fjalë nuk e ka caktuar si avokat sipas detyrës zyrtare por cakton avokat për të cilët ka interesa të caktuara.

Me parashtrësën e datës 20.08.2021, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, ka kërkuar nga avokati .....që ta plotësoj parashtrësën lidhur me deklaratimet e tij, me prova shtesë që do të dëshmonin se gjyqtari ka caktuar pa rend lëndët më të reja të dorëzuara nga avokatët e caktuar meqë, deklaratimet në parashtrësë ishin të përgjithësuara dhe nuk janë mbështetë me asnjë provë dhe si të tilla nuk mund të merren si bazë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit, nëse qëllimi i dorëzimit të parashtrësës nga ana e tij ka qenë i tillë.

Me datë 02.09.2021, sipas fletëkthesës, avokati ....., e ka pranuar Kërkesën e Kryetarit të Gjykatës për plotësimin e parashtrësës së tij por, i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Kryetari i Gjykatës, duke vepruar në kuptim të nenit 5 par.3 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve sipas të cilës çdo ankesë edhe në qoftë se nuk shënohet shprehimisht si ankesë, do të konsiderohet e tillë kur nga përmbajtja del se qëllimi i palës është të paraqes në pretendim për shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit.

Kryetari i Gjykatës, në cilësinë e autoritetit kompetent, ka vlerësuar parashtresën e avokatit .....dhe ka gjetë se pretendimet në parashtresë janë të përgjithësuara dhe nuk janë të mbështetura në asnjë provë. I njëjti, nuk i është përgjigje kërkesës së Kryetarit për plotësim të parashtresës së tij me prova që do t'i mbështesnin pretendimet e tij andaj, autoriteti kompetent ka konstatuar se ankesa si e tillë është dukshëm joserioze dhe e pabazuar. Pretendimet në fjalë, të përgjithësuara nuk mund të merren si bazë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit andaj, ankesa disiplinore refuzohet si e pabazuar.

Avokati ....., në parashtresën e tij ka shpreh pretendimin se qe tri vite nuk i janë caktuar seancat ndërsa, nuk ka prezantuar asnjë dëshmi siç janë kopja e padisë apo diçka të ngjashme me të cilën vërtetohet se paditësi në raport me avokatët e tjerë diskriminohet apo ndonjë provë tjetër me të cilën argumentohet se gjyqtari në procedimin e rasteve nuk i trajton lëndët sipas kronologjisë së ardhjes, kur shtojmë faktin se i njëjti nuk i është përgjigje kërkesës së autoritetit kompetent për plotësimin e parashtresës titulluar si “Njoftim” atëherë autoriteti kompetent ka vendosur si më lartë.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitave ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.13/21, me datë 17.09.2021.**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. Gjyqtarit .....
3. Parashtruesit të ankesës – ....., avokat në Klinë